

VENDIM
Nr. 251, datë 13.12.2021

MBI DHËNIEN E AUTORIZIMIT NGA ERE PËR TRANSFERIMIN E KUOTAVE (NËPËRMJET SHITBLERJES) TË SHOQËRISË “KALISI HYDROPOWER” SHPK NDËRMJET ORTAKËVE EKZISTUES TË SHOQËRISË

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; të pikës 6.2, të “Kushteve të licencës për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 13.12.2021, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 151/9 prot., datë 10.12.2021, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi dhënien e autorizimit nga ERE për transferimin e kuotave (nëpërmjet shitblerjes) të shoqërisë ‘Kalisi Hydropower’ sh.p.k. ndërmjet ortakëve ekzistues të saj”,

konstatoi se:

- Shoqëria “Kalisi Hydropower” sh.p.k. është mbajtëse e licencës për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 71, datë 22.4.2020.

- Shoqëria ka vënë në dijeni ERE-n për transferimin e kuotave ndërmjet ortakëve ekzistues të saj.

- Në zbatim të pikës 6.2, të “Kushteve të licencës për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”, të licencuarit mbartin detyrimin për të kërkuar autorizim në ERE, në lidhje me ndryshimin e ortakut/aksionarit kryesor.

- Të licencuarit mbartin detyrimin për të kërkuar autorizim në ERE, në lidhje me ndryshimin e ortakut/aksionarit kryesor, në zbatim të pikës 6.2, të “Kushteve të licencës për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 218, datë 27.10.2021, “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘Kalisi Hydropower’ sh.p.k. për dhënien e autorizimit nga ERE për transferimin e kuotave”, vendosi:

“1. Të shtyjë me 30 (tridhjetë) ditë pune vendimmarrjen e Bordit të ERE-s, mbi kërkesën e shoqërisë ‘Kalisi Hydropower’ sh.p.k. për dhënien e autorizimit nga ERE për transferimin e kuotave.”.

- Kjo shtyrje erdhi si pasojë e nevojës për të sqaruar rrethanat dhe dokumentacionin që lidhet me barrësimin e kuotave të të tretët, për të cilat shoqëria ka kërkuar autorizimin e ERE-s për transferimin brenda shoqërisë dhe për zhvillimin e seancave të mundshme dëgjimore, për këtë qëllim, e për të sqaruar statusin e barrës sigurorese që vetë shoqëria ka vendosur mbi këto kuota.

- Në seancën dëgjimore të datës 22.11.2021, përfaqësuesit e shoqërisë deklaruan se shoqëria ka marrë miratimin përkatës të bankës për këtë transferim, dokument i cili është depozituar në ERE.

- Në kuadër të kërkesës për marrjen e miratimit të ERE-s, për transferimin e kuotave (nëpërmjet shitblerjes) ndërmjet ortakëve ekzistues të saj, shoqëria ka depozituar informacionin dhe dokumentacionin e nevojshëm.

- Shoqëria ka depozituar në ERE shkresën drejtuar Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë për vënien në dijeni, për transferimin e kuotave ndërmjet shoqërive ortake ekzistuese të shoqërisë “Kalisi Hydropower” sh.p.k. Në lidhje me këtë njoftim që i ka bërë MIE-s, në cilësinë e Autoritetit Kontraktues, vetë shoqëria ka argumentuar në shkresën e saj drejtuar ERE-s se referuar nenit 17.1, të kontratës së koncesionit nr. 1605 rep., nr. 1057 kol., datë 18.7.2018, ku parashikohet se, për çdo transferim të aksioneve të kapitalit themeltar tek të tretët, koncesionari duhet të marrë pëlqim paraprak të autoritetit kontraktues, shoqëria si mbajtëse e koncesionit ka të drejtë që brenda saj të ndryshojë/transferojë aksionet e shoqërive të saj pa pëlqimin e autoritetit kontraktues, pasi në këtë rast nuk është transferim të të tretët, por transferim/shitblerje e aksioneve brenda shoqërisë. Po ashtu, gjatë seancës dëgjimore përfaqësuesit e ERE-s

pyetën përfaqësuesit e shoqërisë, në lidhje me qëndrimin e MIE-s për sa informuar nga shoqëria, të cilët ritheksuan edhe një herë faktin se në zbatim të përcaktimeve të nenit 17.1, të kontratës koncesionare kanë vetëm detyrimin për të njoftuar MIE-n, në cilësinë e AK-së, pasi transferimi i kuotave nuk bëhet te të tretët.

- Në çdo rast, vlerësohet të theksohet se shoqëria nuk çlirohet nga detyrimi për të marrë autorizimet/miratimet përkatëse nga organet e tjera, në lidhje me këtë transferim, kur kjo kërkohet nga këto organe.

- Shoqëria “Kalisi Hydropower” sh.p.k. ka shlyer të gjitha pagesat rregullatore ndaj ERE-s.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Dhënien e autorizimit nga ERE për transferimin e kuotave (nëpërmjet shitblerjes) të shoqërisë “Kalisi Hydropower” sh.p.k. ndërmjet ortakëve ekzistues të shoqërisë.

2. Shoqëria “Kalisi Hydropower” sh.p.k. nuk çlirohet nga detyrimi për të marrë autorizimet/miratimet përkatëse nga organet e tjera për këtë transferim, nëse kjo kërkohet nga këto organe.

3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti